

7.3 ASTAR PËR TRAJTIMIN E SIPËRFAQEVE PËRPARA SE TË APLIKOHEN PLLAKA

DW PRIMER



Njësia matëse	Copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
1 kg/bidon	12cp/kuti	0.2-0.3 kg/m ²	I Verdhë
5 kg/bidon	4 cp/kuti	--	--
10 kg/bidon	60 cp/paletë	--	--



PËRSHKRIMI

DW PRIMER është astar me bazë rezine akrilike, i cili përdoret për t'i dhënë suportit cilësitë e dëshiruara para aplikimit të ngjitësve të pllakave me bazë çimento.

FUSHAT E APLIKIMIT

DW PRIMER mund të aplikohet si shtresë parësore në shumë suporte, si për shembull pllaka të vjetra, sipërfaqe të lëmuara, gurë natyral, sipërfaqe dyshemeje të çimentuara, dru dhe metal.

UDHËZIME PËR PËRGATITJEN

Suporti: sipërfaqja ku do të aplikohet DW PRIMER duhet të jetë pa lagështi, pa pluhura dhe pa pjesë të lyera me vaj.

APLIKIMI

DW PRIMER është i gatshëm për përdorim, i cili aplikohet direkt në suport me anë të një rruli ose furçe. Ngjitësi i pllakave mund të aplikohet pas një ore dhe përsa kohë që DW PRIMER ngjit.

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

Jetëgjatësia e produktit është 18 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketim origjinal dhe mbrohet nga ngricat dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell.

SHËNIME

Temperatura e ambientit gjatë aplikimit duhet të jetë ndërmjet +5°C dhe 35°C. Koha maksimale e lejuar pas aplikimit është 12 orë. Nëqoftëse kjo kohë kalon atëherë nevojitet një shtresë e re para aplikimit të gjitësit të pllakave.

DW PRIMER është i domosdoshëm kur duhet të bëhet ngjitja e pllakës mbi pllakë.

